

**2019**  

---

**RAPORT VJETOR**

<b>Emri i Shoqërisë:</b>	<b>Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group</b>	
<b>Aktiviteti:</b>	Operon në biznesin e sigurimit të jo – jetës në Republikën e Shqipërisë dhe nëpërmjet degës së saj në Kosovë edhe Republikën e Kosovës.	
<b>Data e Themelimit:</b>	<b>Shkurt 1999</b>	
<b>Bordi Mbikqyrës:</b>	Z. Peter Hoefinger	Kryetar
	Z. Christoph Rath	Zv. Kryetar
	Z. Jonard Prodani	Anëtar
	Z. Michael Hack	Anëtar
	Znj. Sonja Raus	Anëtar
<b>Drejtor i Përgjithshëm:</b>	<b>Klaidi Çitozi</b>	
<b>Bordi Drejtues:</b>	<b>Enid Minarolli</b> <b>Ervin Rali</b>	
<b>Aksioner Kryesor:</b>	Shoqëria mëmë është Vienna Insurance Group Ag Wiener Versicherung Gruppe, Vjenë, Austri, e cila zotëron 89.05% të aksioneve.	
<b>Numri i punonjësve:</b>	<b>200</b>	
<b>Agjentë të licencuar:</b>		

**Mbrojmë atë që ka vlerë për ju!**





## Tregu i sigurimeve 2019

Gjate vitit 2019 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej **4.11%**. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 695,015 mijë lekë duke arritur shifrën **17,617,588** mijë lekë.

Numri i kontratave arriti në **1,350,075** duke shënuar një rritje me **3.18%** krahasuar me vitin 2018.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën **16,337,199** mijë lekë duke shënuar një rritje në masën **3.88%** krahasuar me vitin 2018.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën **1,237,276** duke shënuar një rritje në masën **5.20%** krahasuar me vitin 2018.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën **1,215,777** mijë lekë duke shënuar një rritje në masën **6.46%** krahasuar me vitin 2018.

Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në **112,776** duke shënuar një ulje në masën **14.75%** krahasuar me vitin 2018.

Gjatë vitit 2019, janë paguar gjithsej **6,377,264** mijë lekë dëme ose **8.58%** më pak se gjatë vitit 2018.

Numri i dëmeve të paguara në vitin 2019 është rritur me 5,254 dhe arriti shifrën **48,971** nga të cilat 46,778 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 2,193 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.

## Profili i Vienna Insurance Group VIENNA INSURANCE GROUP

» Ne fokusohemi që klientëve tanë në Austri dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore, t'u ofrojmë produkte të përshtatura posaçërisht për nevojat e tyre. Strategjia jonë drejtohet nga përfitueshmëria afatgjatë dhe rritja e qëndrueshme e fitimit, duke na bërë një partner të besueshëm në këto kohë që ndryshojnë kaq shpejt. «

Mbi 25,000 punonjës punojnë për Vienna Insurance Group (VIG), në rreth 50 kompani në 25 vende të ndryshme. Ne zhvillojmë zgjidhje për sigurimet duke u përputhur me nevojat personale dhe lokale, e cila na bën lider në industrinë e sigurimeve në Austri dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore.

### EKSPERTIZË DHE STABILITET

Vienna Insurance Group është një grup ndërkombëtar sigurimesh, me selinë qendrore në kryeqytetin Austriak. Pas rënies së Perdes së Hekurt në vitin 1989, VIG –filloi zgjerimin e tij, nga një biznes totalisht Austriak në një grup internacional. VIG është sinonim i stabilitetit dhe ekspertizës për të siguruar mbrojtje-financiare ndaj rreziqeve të ndryshme. Origjina e grupit, daton në vitin 1824. Afërsisht dy shekuj experiencë, të kombinuara me një focus në aftësinë tonë kryesore, atë për t'u siguruar ndaj rreziqeve, formojnë një bazë të sigurt dhe të fortë për mbi 20 milionë klientët që ka Grupi.

### FOKUS NË EVROPËN QËNDRORE DHE LINDORE

Përveç se në Austri, VIG e konsideron si tregun e tij edhe Evropën Qendrore dhe Lindore. Grupi gjeneron më shumë se gjysmën e të ardhurave nga primet në CEE. Veprimet e VIG janë të fokusuara gjithashtu në këtë rajon. Kjo reflekton kryesisht, parashikimin për rritje ekonomike në Evropën Qendrore dhe lindore, i cili mendohet se do të jetë dy here më e madhe se në Evropën Perëndimore, si dhe niveli i sigurimeve për frymë, i cili është shumë më i ulët se mesatarja Evropiane.

### PREZENCË NE TREGUN LOKAL

Për VIG, mbrojtja e klientëve –financiarisht nga rreziku është një përgjegjësi. Grupi ndjek një strategji multi brand të bazuar në tregjet lokale si dhe në menaxhimin lokal. Së fundmi, suksesi i grupit dhe afërsia me klientin është baza e çdo brandi individual dhe knoë – hoë lokal.

### FINANCA TË FORTA & VLERËSIMI I KREDITIT

VIG ka një vlerësim A+ me një parashikim të qëndrueshëm, nga agjensia e mirënjohur e vlerësimeve, Standard & Poor's, që do të thotë që mbetet kompania e vlerësuar më mirë në indeksin e Bursës së Vienës, ATX. Vienna Insurance Group është e listuar jo vetëm në Vienë por edhe në Pragë. Wiener Städtische Versicherungsverein – një aksioner kryesor i qëndrueshëm me një focus afatgjatë – ka rreth 70% të aksioneve të VIG. Aksionet e tjera tregtohen në bursë.

ALBANIA

**SIGMA**  
INTERALBANIAN  
VIENNA INSURANCE GROUP

**INTERSIG**  
VIENNA INSURANCE GROUP

AUSTRIA

**WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Ionau**  
VIENNA INSURANCE GROUP

BELARUS

**КУПАЛА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

BOSNIA-HERZEGOVINA

**WIENER OSIGURANJE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**vienna osiguranje**  
VIENNA INSURANCE GROUP

BULGARIA

**BULSTRAD**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Life BULSTRAD**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**novains**  
VIENNA INSURANCE GROUP

PENSION ASSURANCE COMPANY  
**DOVERIE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

CROATIA

**WIENER OSIGURANJE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

CZECH REPUBLIC

**Kooperativa**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ČPP**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**VIG Re**  
CZECH REPUBLIC (Headquarter)  
GERMANY (Branch)  
FRANCE (Branch)

ESTONIA

**bta**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**COMPENSA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Seesam**  
VIENNA INSURANCE GROUP

GEORGIA

**GPIA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**IRAO**  
VIENNA INSURANCE GROUP

GERMANY

**InterRisk**  
VIENNA INSURANCE GROUP

HUNGARY

**UNION**  
VIENNA INSURANCE GROUP

ITALY

**WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

LATVIA

**bta**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**COMPENSA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Seesam**  
VIENNA INSURANCE GROUP

LIECHTENSTEIN

**VIENNA-LIFE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

LITHUANIA

**bta**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**COMPENSA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Seesam**  
VIENNA INSURANCE GROUP

MOLDOVA

**DONARIS**  
VIENNA INSURANCE GROUP

MONTENEGRO

**Život WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

NORTH MACEDONIA

**WINNER**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Life WINNER**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ОСИГУРУВАЊЕ МАКЕДОНИЈА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

POLAND

**COMPENSA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**InterRisk**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Vienna Life**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**wiener**  
VIENNA INSURANCE GROUP

ROMANIA

**OMNIASIG**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**Asirom**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**DE VIATA BCR ASIGURARI**  
VIENNA INSURANCE GROUP

SERBIA

**WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**WIENER RE Beograd**  
VIENNA INSURANCE GROUP

SLOVAKIA

**Kooperativa**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**KOMUNÁLNA POISTOVNA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

SLOVENIA

**WIENER STÄDTISCHE**  
VIENNA INSURANCE GROUP

TURKEY

**RAYSIGORTA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

UKRAINE

**КНЯЖА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**life КНЯЖА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**ГЛОБУС**  
VIENNA INSURANCE GROUP

**УКРАЇНЬСЬКА СТРАХОВА ГРУПА**  
VIENNA INSURANCE GROUP

WE ARE NUMBER 1  
IN AUSTRIA, CENTRAL-  
AND EASTERN EUROPE.

**VIG**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
Protecting what matters.

Status: December 2019

## Momente Historike

Shkurt  
1999

U themelua kompania e parë private në Shqipëri, SIGMA - Siguri e Madhe

Tetor  
2002

Sigma hyn në tregun maqedonas dhe liçensohet nga autoritetet vendase. Filloi aktivitetin e saj në 2003.

Shtator  
2004

Sigma liçensohet që të operojë në Kosovë.

Shtator  
2007

Sigma bëhet pjesë e Vienna Insurance Group

Tetor  
2014

U bë bashkimi i kompanive Sigma dhe Interalbanian dhe tani operojnë në treg me emrin Sigma Interalbanian VIG

Maj  
2016

Z. Qemal Disha tërhiqet nga detyra si lider historik i kësaj kompanie për t'ia pasuar menaxhimin e kompanisë, Z. Klaidi Çitozi.

## Historiku i SIGMA INTERALBANIAN VIG

Sigma Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP u themelua në 1999 dhe regjistrua në Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.20487 me datë 3 shkurt 1999. Aktiviteti i saj rregullohet nga nenet e Ligjit Nr. 9901 me datë 14 prill 2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligji Nr. 52 datë 22 maj 2014 "Për aktivitetet e sigurimit dhe risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", dhe aktet nënligjore të dala në funksion të tij.

Aktiviteti i saj kryesor është ofrimi i sigurimit për mjetet motorike, pronën, shëndetin dhe sigurime të tjera jo-jetë.


Shumë shpejt pas krijimit të saj, Sigma vendosi të zgjeronte aktivitetin edhe në rajon, duke hapur degët e saj përkatësisht në Maqedoni në vitin 2002 dhe Kosovë në vitin 2004. Në këto tregje, falë përvojës dhe ekspertizës së stafit, arriti shumë shpejt të pozicionohet si kompani lider.

Në shtator të vitit 2007, VIENNA INSURANCE GROUP vendosi të hyjë në tregun shqiptar, duke blerë aksione të kompanisë Sigma. Kjo kompani jo vetëm solli një frymë evropiane në tregun shqiptar, por ishte një emër që pëcillte gjithashtu stabilitet dhe siguri për klientët.

Gjate vitit 2014, Sigma dhe Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP sh.a. u bashkuan.

Më 30 shtator 2014, emri i Shoqërisë u ndryshua nga "Sigma VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a në "Sigma Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a.


Në Tetor të vitit 2018, Z. Qemal Disha tërhiqet nga detyra si lider historik i kësaj kompanie për t'ia pasuar menaxhimin e kompanisë, Z. Klaidi Çitozi.



Shtrirja e  
SIGMA INTERALBANIAN VIG

## **Bordi Mbikqyrës**

Z. Peter Hoefinger	Kryetar
Z. Christoph Rath	Zv. Kryetar
Z. Jonard Prodani	Anëtar
Z. Michael Hack	Anëtar
Znj. Sonja Raus	Anëtar



## Bordi Drejtues

Z. Klaidi Çitozi – Drejtor i Përgjithshëm

Z. Çitozi është pjesë e kompanisë që prej vitit 2003. Për tetë vjet ka qënë pjesë e bordit drejtues, dhe që prej vitit 2016 edhe si drejtues ekzekutiv i kësaj kompanie. Ai është aktuar i certifikuar dhe me përvojë të gjatë në fushën e marrjes në sigurim.

Z. Enid Minarolli – Zv. Drejtor i Përgjithshëm

Z. Minarolli iu bashkua Sigma Interalbani si Anëtar i Bordit Menaxhues në vitin 2015. Përpara kësaj periudhe, ai ishte i angazhuar në Zyrat Qendrore të VIG në Austri.

Z. Ervin Rali- Anëtar Bordi

Z. Rali ka një eksperiencë shumë të gjatë në sigurime, duke qënë dhe një ndër pionerët e kësaj industrie, veçanërisht në zhvillimet e teknologjisë që ka pasur tregu. Ai iu rikthye kompanisë Sigma Interalbani në vitin 2016 si Anëtar i Bordit të Drejtuesve të kompanisë, duke pasur në fokusin e tij veçanërisht shitjet dhe zhvillimet teknologjike.

## Profil i Sigma InterAlbanian VIG

Viti 2019, shënjoj dhe vitin e 20 të aktivitetit të kompanisë sonë në tregun e sigurimeve. Jo vetëm për ne, por për të gjithë tregun, ai ishte një vit sfidash të vazhdueshme. Pavarësisht situatës financiare në Shqipëri, tregut jo të zhvilluar, fokusimit në sigurimet e detyrueshme, si dhe fenomeneve natyrore që na shoqëruan gjatë këtij viti, kompania jonë arriti të ketë rezultate shumë të mira si dhe një pozicionim të mirë në treg. Mbjajtja e klientëve ekzistues, identifikimi i klientëve të rinj si dhe administrimi efikas i shpenzimeve kanë qënë objektivat tona që prej fillimit të vitit.

Sigurimet kanë në themel besimin e klientëve, ndaj dhe ne përpiqemi fort që të vazhdojmë të kemi besimin e klientëve tanë, si dhe të garantojmë përmbushjen e detyrimeve tona edhe ndaj prurjeve të reja. Ne vendosim klientin në qendër të punës tonë. Kjo reflektohet edhe në normën e lartë të rinovimeve që ka kompania. Klientët vazhdojnë të besojnë tek ne, vazhdojnë të na zgjedhin. Dhe ne, në të njëjtën mënyrë, vlerësojmë të gjitha rastet në mënyrë korrekte dhe paguajmë në kohën e duhur dëmet e shëndetit, pasurisë dhe të automjeteve.

Gjatë fundit të 2019, shumë biznese dhe individë u dëmtuan nga tërmeti. Ky fenomen natyror ishte kryefjala e çdo bisede për një periudhë të gjatë. Kompania jonë, ka trajtuar në kohë rekord dhe me seriozitet të gjitha rastet e dëmtuara dhe që ishin siguruar pranë nesh. Duke qënë të vetëdijshëm për pasojat e tërmetit në vazhdimësinë e biznesit dhe në jetën e individëve, trajtimin të këtyre dëmeve iu është dhënë përparësi absolute.

Ne jemi pararojë në sigurime, duke ofruar këshillim dhe produkte sigurimi për çdo biznes dhe individ, duke iu përshtatur nevojave dhe buxhetit të tyre. Ekipi ynë teknik është i aftë të ofrojë sigurime që i përshtaten çdo kërkesë dhe rrethane në vendin tonë. Njohuritë dhe eksperiencia e stafit tonë, është një ndër pikat e forta të kompanisë. Duke qënë se tregjet financiare janë gjithnjë në ndryshim, ne tregohemi të kujdesshëm që stafi ynë të trajnohet vazhdimisht që t'i përshtatemi sa më mirë dhe në kohë këtyre ndryshimeve. Në stafin tonë kemi punonjës me njohuri teknike të shkëlqyera, por edhe ata me ekspertizën dhe njohuritë mbi ligjet dhe rregulloren në fuqi. Ky është një kombinim i shkëlqyer që na bën zgjedhjen e parë të klientëve që kërkojnë mbrojtje dhe siguri maksimale gjatë aktivitetit të tyre.

Nëpërmjet aplikimit të parimeve të marrjes në sigurim, administrimit të rreziqeve me kontrata risigurimi të klasit parë, ne kemi mundësi të marrim përsipër me garanci të plotë çdo lloj rreziku. Në çdo kontratë sigurimi jemi të mbuluar përveç se me kapacitetet tona, edhe me mbështetjen e VIG Re, e cila është e vlerësuar nga Standarts and Poors me A+. Mbështetja e padiskutueshme e aksionerit tonë kryesor, Vienna Insurance Group, na vë njëherësh edhe përpara përgjegjësisë që të synojmë t'i përmbahemi standarteve më të larta në ofrimin e shërbimeve.

Stafi i kompanisë, i cili ka një eksperiencë shumë të gjatë në sigurime, ofron asistencë teknike dhe shërbim klienti të shkëlqyer. Njohuritë e marra në trajnimet dhe edukimin e vazhdueshëm të punonjësve si në Shqipëri ashtu edhe në grupin VIG, i aplikojmë në punën tonë të përditshme, si në dizejnimin e produkteve të sigurimit, ashtu edhe në mënyrën e përjasjes së klientit apo trajtimit të dëmeve.

Ne jemi krenarë që jemi pjesë e grupit VIG, rrënjët e të cilit datojnë më shumë se 190 vite më parë në Austri. Aktualisht ky grup operon në 25 vende të Europës Lindore dhe Qendrore me më shumë se 50 kompani. Ka një prej vlerësimeve më të mira nga Standards and Poors, A+ dhe një perspektivë e qëndrueshme, ndër kompanië e përfshira në indeksin ATX të Vienna Stock Exchange.

Dega jonë në Kosovë, vazhdon të jetë një histori suksesi, që prej shumë vitesh tashmë, dhe është një nga kompanitë lidere në treg bazuar në volumin e primeve të realizuara për të gjitha linjat e bizneseve.

Mbyllja e vitit 2019, i dha një mundësi reale një fillimi të suksesshëm të 2020, për rritje të treguesve financiarë të kompanisë, veçanërisht në sigurimet vullnetare. Këto janë një motiv i mirë që ne të përpiqemi më tepër për të arritur objektivat tona ambicioze. Ne presim që 2020 të sjellë një pozicion më të konsoliduar në treg sepse kemi kapacitetet e duhura teknike dhe financiare për të mbajtur klientët ekzistues dhe për të tërhequr klientë të rinj.



## Sigma InterAlbanian VIG në shifra

Sigma InterAlbanian ka pasur një ecure të qëndrueshme gjatë vitit 2019. Ju kemi shërbyer më shumë se 150 mijë klientëve duke ju ofruar produktet tona, dhe kemi dëmshpërblyer mbi 6.000 klientë. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto gjatë këtij viti kanë arritur shifrën prej mbi 18 milionë Euro dhe zotëron rreth 14% të tregut. Rreth 27% e këtyre primeve vijnë nga sigurimet vullnetare.

Është kompania e dytë në treg për sigurimet TPL me mbi 15% të tregut. Një pozicion mjaft të mirë ka kompania edhe në sigurimet e pronës, duke zotëruar 14% të tregut dhe duke shënuar një rritje prej afërsisht 8% ndërkohë që rritja mesatare e tregut ishte 4.37%. Gjithashtu edhe sigurimet e shëndetit kanë pasur një rritje shumë të mirë krahasuar me vitin e kaluar, prej 13.6%, ndërkohë që tregu për këtë produkt ka pësuar një rënie prej afërsisht 6%.



Mbi 150 mijë Klientë




e totalit të tregut



Mbi 6.000 klientë të dëmshpërblyer

**2**

Kompania e dytë në TPL me mbi 15% të tregut



8% rritje në sigurimet e pronës.

Mbi 13% rritje në sigurimet e shëndetit.



Ne jemi sinonim i stabilitetit dhe kompetencës përsa i përket mbrojtjes nga rreziku. Ne përdorim eksperiencën, njohuritë dhe diversitetin tonë për të qënë më pranë klientëve tanë. E konsiderojmë përgje gjësinë tonë që të mbrojmë ato që kanë vlerë për klientët tanë.

MISIONI

VIZIONI

Ne duam të jemi zgjedhja e parë për klientët tanë. Grupet e interesit na shohin si një partner të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Kjo bën të mundur që ne të forcojmë pozicionin tonë si grupi lider në sigurime në Austri, Europën Qendrore dhe Lindore.

VLERAT

PREMTIMI

Diversiteti,  
Mardhënia me klientin,  
Përgjegjësia.

Ne bëjmë të mundur që klientët tanë të jetojnë një jetë më të sigurt dhe më të mirë sepse ne:  
**Mbrojmë atë që ka vlerë për ju!**

## VIZIONI YNË

Ne duam të jemi zgjedhja e parë për klientët tanë. Grupet e interesit na shohin si një partner të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Kjo bën të mundur që ne të forcojmë pozicionin tonë si grupi lider në sigurime në Austri, Europën Qendrore dhe Lindore.

## Rigrafikim i logos së SIGMA INTERALBANIAN VIG

2019 ishte një vit i rëndësishëm për kompaninë tonë. Duke qënë se ishte 20 vjetori i themelimit të saj, Bordi i Drejtorëve të kompanisë vendosi që të bëjë një rigrafikim të logos.

Duke qënë se emri Sigma Inter Albanian VIG është mjaft i gjatë, fillimisht u konsiderua të ndryshohej edhe emri, në një emër më të shkurtër dhe më modern. Si Sigma ashtu dhe Inter Albanian kanë qënë emra që kanë pasur besimin e publikut për një kohë shumë të gjatë dhe janë simbol i stabilitetit financiar dhe një shërbimi të shkëlqyer ndaj klientit. Ende sot, këto cilësi vazhdojnë të na udhëheqin në punën tonë, prandaj ishim të bindur që ky ndryshim nuk do të ndryshonte perceptimin e klientëve për kompaninë.

Gjithsesi, studimi i tregut që u bë përpara se të vendosej për këtë ndryshim, tregoi se klientët tanë, veçanërisht individët, e lidhin emrin Sigma Inter Albanian me traditën e gjatë në sigurime. Një emër i ri do i bënte ata të mendonin që një kompani e re ka hyrë në treg, dhe “e re” në sigurime është pothuajse krejt e kundërta e “besimit” dhe “stabilitetit”.

Kështu që, u vendos që të mendohej për ndryshimin e emrit në një moment tjetër dhe të bëhej vetëm një rigrafikim i logos. Qëllimi ishte që emri i kompanisë të ishte më i dukshëm se në logon aktuale, duke i dhënë hapësirën e duhur të dy fjalëve. Logoja përmban të njëjtin element grafik, KAHUNA – Simbol i Mbrojtjes – dhe e njëjta ngjyrë e simbolit si më parë.

Ngjyra e bardhe dhe e kuqe janë dhe ngjyrat e Austrisë, dhe kështu na ndihmojnë të identifikohemi si kompani asutriake. Ne besojmë se elementi grafik i pandryshuar, krijon më pak konfuzion tek klientët. Pjesa e poshtme e logos është e njëjtë për të gjitha kompanitë e grupit VIG.



## Digjitalizimi- fjalë kyç në Sigma InterAlbanian VIG

Jemi të vetëdijshëm që fjalët “trend” dhe “sigurim” nuk do i mendonim ndonjëherë të shkonin së bashku në të njëjtën fjali, por me sa duket jemi gabuar. Tashmë në celularin tonë, përveç aplikacioneve informative të ndryshme, mund të keni dhe aplikacionin utilitar të kompanisë tonë. Drejtori i Përgjithshëm, Z. Klaidi Çitozi, e pranoi menjëherë propozimin për krijimin e këtij aplikacioni dhe mbështeti personalisht procesin. Teknologjia tashmë është në duart e të gjithëve dhe pse të mos jemi edhe ne më pranë klientit nëpërmjet lehtësirave që sjell ajo?

Digjitalizimi është një ndër prioritetet e grupit VIG, kështu që edhe ne kemi synim të ecim me të njëjtin hap si kompanitë simotra në këtë drejtim. Së fundmi kemi lançuar aplikacionin SIVIG për celular si dhe shitjen online nëpërmjet eeb dhe aplikacionit.


Përveç informacioneve të shumta që mund të merrni për produktet e ndryshme në çdo moment, klienti tashmë mund të bëjë dhe blerjen e disa policave sigurimi direkt nga celulari. Për shkak të thjeshtësisë së procedurave të marrjes në sigurim, aktualisht nëpërmjet aplikacionit mund të blihen vetëm siguracionet e detyrueshme motorike, që janë TPL, Karton jeshil, Polica kufitare si dhe Shëndeti në Udhëtim.

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, polica e sigurimit është e vlefshme vetëm kur është fizikisht e printuar, prandaj me anë të aplikacionit mund të bëhet vetëm porosia dhe pagesa, dhe brenda një afati kohor shumë të shkurtër polica e sigurimit dorëzohet në adresën që gjendet në të dhënat personale në aplikacion. Proçesi i regjistrimit zgjat vetëm 10 minuta, dhe është pa pagesë.

Duke u regjistruar si përdorues i tij, klientët mësojnë në kohë reale për ofertat e ndryshme që aplikon kompania si dhe fitohen pikë për çdo blerje të kryer. Këto pikë mund të përdoren në blerjet e mëvonshme, duke aplikuar zbritje në çmimin fillestar të produktit.

Shumë shpejt do të bëhet e mundur që procedurat për dëmshpërblim të iniciohet nga celulari, duke dërguar fotot dhe informacionin e nevojshëm direkt nga vendi i ngjarjes. Çdokush që ka një praktikë dëmi pranë kompanisë, mund të shikojë etapat në të cilat po kalon trajtimi i rastit të tij në kohë reale.

Aplikacioni mund të shkarkohet me emrin SIVIG në AppStore dhe Google Play por klientët mund të blejnë policat e tyre edhe nëpërmjet webit



Nëse ende jeni skeptikë nëse duhet të filloni të kurseni kohë dhe para duke përdorur këtë aplikacion, nuk ju kemi thënë ende gjithçka. Ndërkohë që ju kryeni transaksionin për blerjen e policës, jeni lidhur direkt me bankën, dhe asnjë nga të dhënat e kartës tuaj nuk ruhet në serverin e kompanisë. Kjo ju mbron nga çdo mundësi keqpërdorimi i të dhënave tuaja personale dhe ato bankare. Për të kryer një blerje nëpërmjet këtij aplikacioni mund të përdoret si karta e kreditit ashtu dhe ajo e debitit.

Por ky aplikacion ofron shumë më tepër se të blesh një policë sigurimi. Shumë persona kanë nevojë të informohen mbi produktet e sigurimeve, për çmimet e paketave të ndryshme apo duan të takojnë një përfaqësues të kompanisë personalisht. Një rubrikë me informacion për çdo produkt, një rubrikë tjetër me pyetjet më të shpeshta, një hartë digjitale që përmban pikat e autorizuara të shitjes, pikat e servisit të kontraktuara nga kompania si dhe rrjetin mjekësor SIVIG, do të jenë në dispozicion të përdoruesve nëpërmjet aplikacionit.

Klientët janë gjithnjë e më tepër të angazhuar në përditshmërinë e tyre dhe nevoja për produkte sigurimi është gjithnjë në rritje. Nëpërmjet aplikacionit ne u ofrojmë të gjithëve mundësinë të njihen me produktet dhe tarifatat tona në çdo moment dhe të kenë mundësinë t'i bëjnë të tyret kur ata kanë kohë dhe jo vetëm

Një klient i mirëedukuar dhe i mirëinformuar ka më shumë gjasa të krijojë një marrëdhënie besimi me kompaninë e duhur dhe këtë synojmë të arrijmë nëpërmjet përdorimit të teknologjisë në punën tonë.

Por nëse mjetet më lart kanë si qëllim të lehtësojnë rrugën e klientit për të arritur tek kompania, ne kemi menduar gjithashtu edhe për punonjësit. Gjatë 2019 është punuar shumë për aplikacionin RETM – Risk Evaluation Through Mobile- i cili ju mundëson punonjësve të marrjes në sigurim si dhe agentëve të shitjes të ngarkojnë direkt fotot e objektit që po merret në sigurim në këtë aplikacion. Kështu krijohet harta e pronave të siguruara dhe kemi një mundësi më të mirë për vlerësimin e riskut si dhe shpërndarjen e tij.

← Regjistro Pronë

Numri Serial      Tipi i Policës

Emri i Kompanisë

Ka ngjarje të mëparshme

Objekt

Emërtimi      Lloji i biznesit

Lloji i ndërtesës      Lloji i konstruksionit

Data e fillimit      Data e mbarimit

Monedha

Ndertesa

RUAJ

## Parimi i vlerësimit dhe menaxhimit të riskut

Procesi i vetevlerësimit të risqeve dhe aftësisë pagueuse është një proces i brendshëm që shoqëria do të kryejë çdo vit për të vlerësuar pershtatshmerinë e menaxhimit të riskut dhe pozicionin e saj të tanishëm dhe të ardhshëm të aftësisë pagueuse, në rastet normale të funksionimit dhe në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme (stress testing).

### Struktura e Menaxhimit të Riskut të Shoqërisë

Departamenti i Menaxhimit të Riskut është struktura përgjegjëse e monitorimit të riskut. Gjithashtu, struktura përfshin edhe një Komitet të Menaxhimit të Riskut, i miratuar nga Bordi i Drejtoreve.

### Vetevlerësimi i Risqeve dhe Aftësisë Pagueuse

Procesi i vetevlerësimit të Risqeve dhe aftësisë pagueuse të shoqërisë përbehet nga disa faza:

- i. Procesi i Kontrollit të Risqeve
  - a. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve
  - b. Vlerësimi kualitativ ose kuantitativ
  - c. Monitorimi, masat dhe kontrollet
  - d. Raportimi
- ii. Prova e Rezistencës
- iii. Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Pagueuse
- iv. Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit dhe Testimi i Tij
- v. Profili i Përgjithshëm i Riskut

### **Procesi i Kontrollit të Risqeve**

Procesi i kontrollit të risqeve fillon me inventarizimin e tyre. Duke u bazuar në template të Vienna Insurance Group ("Shoqëria meme"), kemi bërë inventarizimin e risqeve kryesore të shoqërisë. Për çdo risk të identifikuar është bërë vlerësimi frekuence/shkalle e rëndësie, mënyrën që ata përdorin për vlerësimin e riskut dhe masat/kontrollet e ndermarra për secilin risk, nëse ka të tilla të nevojshme.

### **Prova e Rezistencës**

Prova e rezistencës është një teknikë e cila përdoret për të matur ndjeshmerinë ndaj ngjarjeve që kanë një probabilitet të vogël për të ndodhur, por që kanë një efekt të konsiderueshëm kur ato ndodhin. Dy metodat kryesore të këtij testimi janë analiza e ndjeshmerisë dhe analiza e skenareve.

Faktoret makroekonomike kanë një efekt të madh në këto lloje testimi. Risqet si ato të tregut, të kreditit apo operacionale janë drejtperdrejte të lidhur me luhatjet në normat e interesave, cmimet e asetëve, dhe kursin e këmimit.

## 1. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

Qellimi i procesit të Inventarizimit është identifikimi dhe kategorizimi i Risqeve.

Risqet kryesore të identifikuara ndërkombëtare janë:

- Risku i Tregut
- Risku i Marrjes në Sigurim se Jo-jetes
- Risku i Marrjes në Sigurim se Produktit të Shen-detit
- Risku i Aktiveve të Patrupezuara
- Risku i Falimentimit të Pales Tjeter
- Risku i Likuiditetit
- Risku Operacional
- Risku i ndërprerjeve të aktivitetit
- Risku i përqendrimit të njohurive
- Risku i burimeve njerezore të pamjaftueshme
- Risku i hardware dhe infrastruktures
- Risku i software dhe i sigurise
- Risku i modelimit dhe kualitetit të të dhënave
- Risku i zhvillimit të IT
- Risku i projekteve
- Risku i përputhshmerise ligjore të lidhura me sigurimet
- Risku i përputhshmerise ligjore të tjera
- Risku i proceseve dhe organizimit
- Risku i gabimeve njerezore
- Risku Strategjik
- Risku i Reputacionit

### **Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftesise Pagueve**

Bazuar në ligjin nr. 52/2014 datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", shoqëria duhet të mbajë një fond garancie minimum në shumën 370 milion leke (ose jo më pak se 1/3 e marzhit të aftesise paguese minimale).

### **Plani i Vazhdimesise se Aktivitetit dhe Testimi i Tij**

Plani i vazhdimesise se aktivitetit është formuluar dhe është përditësuar nga shoqëria për tju përshatur ndryshimeve në strukturën e shoqërise. Në plan parashikohen hapat që duhet të ndërmerren në rast të llojeve të ndryshme katastrofash, si dhe përcaktohen personat përgjegjës për grupet e ndryshme të punës.

### **Profili i Përgjithshëm i Riskut dhe Konkluzioni**

Duke konsideruar të gjithë analizën e mesiperme dhe gjetjet e rezultuara, arrijmë në përfundimin që shoqëria ka një nivel menaxhueshëm të riskut në teresi.

## 2. Vleresimi kualitativ ose kuantitativ

Në këtë proces bëhet vleresimi i risqeve materiale. Vleresimi bëhet në bazë të dy parimeve : frekuenca dhe shkalla e rëndësisë.

## 3. Monitorimi, masat dhe kontrollet

Monitorimi i të gjithë risqeve është i detyrueshëm dhe kryhet të paktën një herë në vit.

Në këtë proces monitorimi merr rëndësi vleresimi i bërë i riskut dhe ndarja sipas shkallës së rrezikut.

## 4. Raportimi

Raportimi tek Bordi i shoqërise përmban nivelet e risqeve dhe masat që duhen marrë për ato risqe të klasifikuara shqetësuese.



## Çmimi Günter Geyer 2019 për përgjegjësinë Sociale

Ky çmim ka filluar të jepet në vitin 2012, dhe evidenton kompanitë e grupit VIG për përkushtimin që kanë ndaj kausave sociale në vendin e tyre. I është dhënë emri i Kryetarit të Bordit Drejtues të Wiener Städtische, për shkak të ndjeshmërisë së tij ndaj çështjeve të tilla, dhe t'a nxisë këtë përkushtim edhe tek kompanitë dhe punonjësit e grupit VIG.

Në vitin 2019, një ndër fituesit ishte dhe Sigma InterAlbanian VIG, për përkushtimin e madh që ka treguar në projektet e tyre. Kompanisë iu akordua çmimi i bronzë, në shumën prej 20.000 Euro për projektin e tyre për të ndihmuar disa fëmijë në një fshat të izoluar që quhet Mamël. Fëmijët duhet të bëjnë 80 minuta çdo ditë për të vajtur në shkollë, dhe shpesh kur moti është i keq ju duhet edhe të rrinë në shtëpi.

Transporti për në shkollë është shpesh i papërbalueshëm financiarisht nga familjet e tyre. Stafi i Sigma InterAlbanian, në bashkëpunim me Fundjavë Ndryshe, mundësoi këtë transport përgjatë gjithë vitit shkollor. Të cilët për shkak të vështirësive financiare të familjeve të tyre, shpesh e kanë të pamundur të paguajnë transportin për në shkollë. Në mënyrë që të mbajnë të zgjuar interesin e fëmijëve dhe prindërve që ata të shkollohen, kompania ka premtuar që do të vazhdojnë të mbështeten vetëm nëse rezultatet e tyre në shkollë janë shumë të mira.

Përveç kësaj mbështetje, stafi organizon shpesh mbledhjen e veshjeve, aksesoreve shtëpiakë, ushqime, libra dhe kancelari, dhe ua dhuron këtyre familjeve. Përveç kësaj nisme, Sigma InterAlbanian ka kontribuar në pjesërisht në ndërtimin e Qendrës së Solidaritetit të Fundjavë Ndryshe; ka kontribuar për ushqimin në mensën e të varfërve të Kryqit të Kuq Shqiptar, si dhe paguan trajtimin për disa fëmijë autikë në Shqipëri.



## Shqipëria – Ndërtimi në kontekstin politik të dekadave

Në vjeshtë të vitit 2019 seria e aktiviteteve „Arkitektura në Ringturm“ i ‘Wiener Städtischen Versicherungsverein’ e ngre perden e „tokës së panjohur“ të Evropës: Shqipërisë. Në „tokën e panjohur“ për një kohë të gjatë “të shqiptarëve“ arkitektura paraqet një disiplinë relativisht të re kulturore. Që nga rënia e regjimit komunist, zhvillimi arkitektonik në Shqipëri qëndron në shenjë të tranzicionit me të gjitha format e dukurisë së tij. Ekspozita e ardhshme mbledh një përzgjedhje të shquar prej artefakteve të rralla arkitektonike të 100 viteve të kaluara nga e gjithë Shqipëria.

Deri në vitet e hershme të 1990-ave, Shqipëria konsiderohej si „sekreti i fundit i Evropës“, pothuajse askujt nuk i lejohej hyrja. Ende edhe sot ndërmjetësimi i njohurive për vendin kufizohet në masë të gjerë në literaturë turistike. Në këtë ekspozitë „Arkitektura në Ringturm“ ndërton një urë dhe i përkushtohet, së bashku me katalogun përkatës, kulturës së larmishme të ndërtimit të vendit më jugor evropian në detin Adriatik.

Periudhat relevante kohore nga perspektiva arkitektonike, që nga pavarësia e Shqipërisë në fillim të shekullit të 20-të, mund të ndahen në katër pjesë: koha nga Lufta e Parë Botërore deri në vitin 1939, pushtimi i Shqipërisë nga trupat italiane deri në vitin 1943, vitet e diktaturës komuniste deri në 1990-tën – dhe me në fund periudha kohore nga 1990-ta deri më sot. Edhe pse konteksti politik është gjithmonë me rëndësi të jashtëzakonshme për krijimin e arkitekturës, në Shqipëri ai zë një vlerë të veçantë – ky zhvillim nuk mund të krahasohet me asnjë vend tjetër.

Aktualisht, zhvillimi arkitekturor ndikohet nga procesi i tranzicionit, dhe nga një ambient i cili, krijimin e një arkitekture cilësore e ka urdhër të lartë, si pasojë e marrëdhënieve komplekse midis privatizimit, kthimit të pronave dhe investimeve ndërkombëtare. Planfikimi urban dhe rajonal entuziast tani ka për qëllim për të krijuar mekanizma kontrolli dhe struktura të cilat do të sigurojnë një bazë për arkitekture solide, afat-gjatë dhe me vlerë të larë.



## Sigma InterAlbanian VIG NË NDIHMË TË FAMILJEVE TË PREKURA NGA TËRMETI

Duke qënë pranë individëve dhe bizneseve prej kaq shumë vitesh, natyrshëm vjen dhe përgjegjësia e madhe jo vetëm ndaj klientëve tanë, por dhe qytetarëve në nevojë të ndihmave për shkak të tërmetit të datës 26 Nëntor. Ndaj dhe Sigma InterAlbanian ka dhuruar 25,000 Euro në ndihmë të rimëkëmbjes së familjeve të dëmtuara.


Përpos donacionit monetar, kompania gjatë gjithë kësaj periudhe ka kontrolluar dhe vlerësuar rreth 500 dosje me raste të dëmtuara nga tërmeti të cilat arrijnë në vlerën 5,000,000 Euro. Pronat në fjalë janë kryesisht pasuri të siguruara për efekt kredie në Bankat e nivelit të dytë dhe biznese, ndërkohë që numri i individëve të cilët e kanë siguruar vetë, vullnetarisht banesën e tyre është relativisht i ulët.

Në një atmosferë të tillë, Sigma InterAlbanian VIG dëshiron t'i kujtojë bizneseve detyrimin moral për të dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e situatës së popullit shqiptar pas tërmetit të 26 Nëntorit, si dhe të kujtojë qytetarëve të tregohen të kujdesshëm dhe më të përgjegjshëm dhe të sigurojnë banesat e tyre për të qenë të mbrojtur në çdo moment, ndaj çdo të papriture.



## Baleti në Akull

Balet në Akull- brenda sallës së Pallatit të Kongreseve duke e shndërruar për herë të parë të ekzistencës së saj në një pistë të shndritshme akulli. Trupa Shtetërore e Shën Petersburgut performoi më datë 16 Nëntor 2019, me rreth pesëdhjetë balerinë profesionistë dhe fitues çmimesh të Konkurseve Botërore dhe Evropiane të Patinazhit dhe Lojrave Olimpikë, të cilët kanë qenë ndër vite pjesë e Baletit në Akull të Shën Petersburgut. Baleti në Akull solli një performancë të jashtëzakonshme me një ndërthurje zhaneresh, ku baleti klasik ishte baza e kësaj shfaqje, me koreografi të ndërthurur mbi kompozimin e Pyotr Ilyich Tchaikovsky, por patinazhi dhe akrobatikë mbi akull ishin magjia e vërtetë e mbrëmjes. Sigma Interalbani menjëherë e përqafoi idenë për të mbështetur këtë eksperiencë të paharrueshme për publikun shqiptar.



## Sigma Interalbani mbështet më shumë se “Tre tenorët” këtë vit

Sigma Interalbani gjithnjë ka qënë në mbështetje të artit dhe prej disa vitesh tashmë edhe pranë shfaqjes “Tre Tenorët”. Menduar si një festë, ditëlindja e 20-të e shfaqjes “Tre tenoret” erdhi për publikun më 03 Tetor 2019. Në atë atmosfere të tillë festive, shfaqja solli për publikun e Tre Tenorëve të tjerë artiste për të nderuar dhe përgëzuar vetë nismën. Në faqen zyrtare të spektaklit të këngës Lirike “Tre tenorët Shqiptare” ne siglën hyrëse ishin përshëndetjet e tenorëve nga bota, që në atë kohë te ndodhur ne Tirane, secili ka shprehur mesazhet e veta përshëndetëse.

Në atë edicion ishin 10 tenorë ndërkombëtarë që përshëndetën “Tre tenorët” shqiptarë. Tenorët pjesëmarrës ishin nga vende të ndryshme të botes si nga Kina, Japonia, Italia, Spanja, Bregu i Fildishtë, Uruguai, Koreja e Jugut.

Në këto vite kanë debutuar edhe tenorët e mirënjohur shqiptarë, duke nisur me artistin e shquar të skenes lirike “Artistin e Popullit” Gaqo Çaka, i ndarë nga jeta pak kohë më parë. Josif Gjipali, Kastriot Tusha, Agim Hushi, Adrian Xhema, etj, kanë qënë pjesë e “Tre tenorëve”. Një rol me rëndësi në këtë shfaqje, kanë pasur edhe dirigjentët që kanë drejtuar orkestrën apo edhe instrumentistët që u janë bashkuar emocioneve që sillte skena.

Dirigjentë të huaj dhe shqiptarë, bashkë me emra të njohur instrumentistësh (ndër ta violinistja Ervis Gega, një emër i konsoliduar në artin e interpretimit dhe prestigjin e saj ndërkombëtar) kanë interpretuar vepra të njohura për publikun. Orkestrën e asaj mbrëmjeje të atij edicioni jubilar, organizatorët ia kanë besuar dirigjentit Leonardo Quadrini. Bashkë me ariet e kompozitorëve më të mëdhenj botërorë, në “Tre tenoret” janë interpretuar dhe vepra shqiptare të shkruara nga kompozitorët më të njohur tanët si: Çesk Zadeja, Feim Ibrahim, Tonin Arapi, etj. Kjo mbrëmje u mbyll me me versionin e 10 tenorëve të: “Rrjedh në këngë e ligjërime”, këngë e shkruar nga kompozitori Feim Ibrahim me vargje të poetit Gjok Beci.

Në shfaqjen e kësaj mbremjeje ishin të ftuar sopranoja Ramona Tullumani dhe pianisti Genc Tukiçi.



## Tirana Triathlon

E kthyer tashmë në një traditë të bukur, për të dytin vit, Liqeni i Farkës mikpritri garën Triathlon-it në Tiranë, një sport që bashkon tre disiplinat sportive më të njohura dhe të praktikuara në një garë të vetme: not, çiklizëm, vrap. Në garë morën pjesë sportistë profesionistë dhe amatorë. Në nisje të saj, kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, përshëndeti pjesëmarrësit dhe qytetarët e shumtë të ardhur në Parkun e Farkës, i cili falë investimeve të bashkisë është kthyer në një destinacion turistik e sportiv.

Në garë morën pjesë sportistë profesionistë dhe amatorë. Në nisje të saj, kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, përshëndeti pjesëmarrësit dhe qytetarët e shumtë të ardhur në Parkun e Farkës, i cili falë investimeve të bashkisë është kthyer në një destinacion turistik e sportiv. Sigma InterAlbanian VIG e mbështeti kwtw aktivitetet dhe dhuroi për fituesit meshkuj dhe femra vlera monetare.



## Ballo Vjeneze në Tiranë

Pas suksesit të edicionit të parë, që solli eksperiencën mahnitëse të Valsit Vjenez, muzikës së mrekulueshme dhe performancat e shkëlqyera artistike, ishim të lumtur të mbështesim edicionin e dytë të Ballos Vjeneze në Tiranë.

Edicioni i dytë i Ballo Vjeneze u zhvillua ditën e Premte, më 12 Prill 2019, në Pallatin e Kongreseve, duke mbledhur bashkë miq Shqiptarë dhe Austriake, personalitete, njerëz të biznesit, artistë dhe çdo qytetar që ka pikë të dobët muzikën klasike dhe vals in vjenez. Nën kujdesin e Bashkisë së Vjenës dhe Bashkisë së Tiranës, edicioni i dytë i Ballos Vjeneze në Tiranë konsolidoi këtë traditë të mrekulueshme, prezente në metropolet më të rëndësishme të botës.

Balloja Vjeneze daton si traditë që në shekullin e XIV-të dhe arriti majën e shkëlqimit gjatë Kongresit të Vjenës, kongresi në të cilën morrën pjesë gjithë shtetet dhe fuqitë Evropiane në përpjekje për të arritur një marrëveshje për një rend të ri në kontinentin e vjetër.

Sot më shumë se 400 ballo organizohen çdo vit në Vjenë me një numër vizitorësh më të madh se 500.000 vetësh. Balloja Vjeneze është shndërruar në një eksport të suksesshëm kulturor dhe organizohet më shumë se 30 herë në vit në metropolet më të rëndësishme botërore: Athinë, Berlin, Bruksel, Londër, Madrid, Moskë, Nju Jork, Paris, Pekin, Pragë, Romë, Tokjo, Zyrih etj.

Përveç simbolikës kulturore, eventi është një manifestim i miqësisë Shqiptaro-Austriake dhe përbën një hap tjetër për të intensifikuar bashkëpunimin mes kombeve tona. Për të dytin vit, Shqipëria do ta mirëpresë këtë event.



## Edicioni i 17 i festivalit Marie Kraja

Edicioni i 17-të i Festivalit Ndërkombëtar Marie Kraja, ka shënuar një festë të vërtetë talentesh e prezantimesh dinjitoze në skenën e koncerteve të katedrales ortodokse në Tiranë dhe Sigma Interbalkan ishte përsëri promotore e këtij event. Me çmimin e parë, që shkon në Kore këtë vit, u nderua Dongho Kim Bass bariton, me çmimin e dytë mezo-sopranoja Ezdi Karakaja, çmimi i tretë mes interpretuesve, Faik Mansu Bariton, e sopranos shqiptare Nina Muho, si edhe çmimi i orkestrës për Kirill Matiev, është vendosur edhe një gur tjetër shënjes në rrugëtimin e suksesëshëm të tij.

Zana Çela, pjesë e jurisë ndërkombëtare, më e madhja e festivaleve, deri më tani, flet e emocionuar dhe e lumtur për ecurinë e tij. Ndërkohë, puna dhe përpjekjet për të pasur, vitin që vjen, edicionin e radhës, do të jenë të mëdha, natyrisht fituesi Tongo Kim është tejet i lumtur për fitoren, madje pjeëmarrja e tij vjen menjëherë pas një aktiviteti ndërkombëtar tjetër. Ai u shpreh: “Nuk më besohet akoma, sepse ishin të gjithë shumë të talentuar, dhe unë isha tejet i emocionuar. Vitin e shkuar kam mbaruar akademinë në La Scala, e ndërkohë një javë më parë isha në Las Palmas, e erdha tejet i emocionuar e nervoz, por fat i madh që i’a dola.”

Çmimi i dytë, Ezdi Karakaya, u shpreh duke thënë: “Jam kaq e lumtur që jam këtu, si edhe krenare për veten, për çmimin e sapo fituar.”

Mbrëmja solli sërish në konkurim të 8-të të përzgjedhurit e natës finale, Itali, Spanjë, Rusi, Ukrainë, Turqi, Kinë, Kore, Shqipëri,



Francë dhe Greqi, përveç ngjyrave të arieve 600 vjeçare, e këngëve të përzgjedhura të vendeve të tyre. Supriza ishin edhe tingujt e mrekullueshëm të Elvin Hoxhës, si edhe interpretimi i arieve të Murat Karahan, Drejtori i të gjithë Operave të Turqisë.

Ndërkohë një retrospektive e sukseseve të fituesve të edicioneve të shkuara, së bashku me urimet për sukses të konkurrentëve, u soll në sallë si një dëshmi, se tashmë festivali është kthyer në një mundësi të artë për talentet e vokaleve operistike.

## Permbledhje e rezultateve te Auditimit te Brendshëm

Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2019 në shoqërinë Sigma InterAlbanian VIG është kryer në përputhje me Planin Vjetor dhe Planin tre-vjecar 2019 – 2022, të Auditit të Brendshëm, të cilat janë përgatitur bazuar në analizën e risqeve dhe janë miratuar në Mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë në muajin Dhjetor 2018.

Kryerja e angazhimeve audituese është bazuar në Kartën e Auditit të Brendshëm, në Manualin e Auditit të Brendshëm, në Parimet kryesore e Auditit të Brendshëm të Vienna Insurance Group dhe në Rregulloren Nr. 153 të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare “Për veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në shoqërinë e sigurimit”.

Gjate vitit 2019 Departamenti i Auditit të Brendshëm ka audituar aktivitetet e shitjes, të marrjes në sigurim, të menaxhimit të riskut, të trajtimit të dëmeve, të risigurimeve, të administrimit, të finances dhe të teknologjise së informacionit, duke përfshirë departamentet në zyrat qendrore dhe degët e shoqërisë dhe duke mbuluar kështu plotësisht të gjitha fushat e veprimtarisë së saj.

Aktivitetet e shitjes drejtohen nga Departamenti i Shitjes në Drejtorinë e Përgjithshme dhe përmbushen nga Zyra Qendrore, Degët e Shitjeve dhe Ndërmjetesit e licensuar të shitjes të shoqërisë Sigma InterAlbanian VIG.

Kontrollet e Auditit të Brendshëm për vitin 2019 në aktivitetet e shitjes janë fokusuar në zbatimin rregullores së brendshme të shoqërisë, rregjistrimin e saktë dhe pa vonesa të policave të sigurimit në programin e shitjes, arketimin e primeve vecanërisht për produktet

vullnetare, menaxhimin e llogarive të parashënimeve për shitjen, duke u bazuar edhe në kërkesat e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për rregjistrimin dhe raportimin në kohë reale të policave të sigurimit të detyrueshëm.

Gjithashtu puna audituese është përqendruar në zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve të brendshme të Bordit Drejtues lidhur me menaxhimin e komisioneve dhe bonuseve të shitjes, procedurat e marrjes së agjenteve të rinj dhe largimin e agjenteve egjistues, etj.



Kontrollet e shitjes se produkteve te detyrueshme, TPL, Karton Jeshil dhe Kufitare janë përqëndruar më së shumti tek risqet e mundshme që shfaqen si pasojë e gabimeve në rregjistrimet e policave të shitura në programin e shitjes, në saktësinë e të dhënave lidhur me kategorinë e automjetit, periudhen e sigurimit etj.

Aktivitetet e marrjes ne sigurim dhe menaxhimit te riskut gjate vitit 2019 kane funksionuar te harmonizuara me njera tjetren. Per cdo rast Komiteti i Menaxhimit te Riskut ka analizuar risqet e mundshme dhe ka miratuar marrjen ne sigurim dhe ofertat per percaktimin e primit ne perputhje me rregulloren e brendshme dhe urdhrat e Bordit te Drejtoreve te nxjerra per kete qellim. Shoqeria i ka kushtuar vemendje dhe ka permiresuar dokumentacionin e nevojshme per analizimin e risqeve te marrjes ne sigurim te pronave.

Funksionet e trajtimit te demeve, të kontabilitetit dhe të teknologjisë së informacionit janë transferuar në një kompani shërbimi, VIG Services Shqiperi. Kriteret e ofrimit te shërbimeve te transferuara dhe treguesit e performances jane te percaktuara ne Marreveshjen e Nivelit te Shërbimit (SLA Agreement) ndermjet shoqerise Sigma InterAlbanian VIG dhe VIG Services Shqiperi. Kjo marreveshje eshte perditesuar ne muajin Tetor 2017 dhe per pjese te vecanta ne menyre te vazhdueshme.

Auditimet e realizuara gjate vitit 2019 ne aktivitetet e trajtimit te demeve jane fokusuar ne zbatueshmerine e ligjeve ne fuqi, Rregullorene te AMF dhe Rregullorene te brendshme te miratuara nga shoqeria. Kontrollet e Auditit te Brendshem gjate vitit 2019 kane synuar te mbulojne te gjitha llojet e demeve, si ato materiale, motorrike (Kasko dhe TPL); demet e prones, ashtu edhe demet jomateriale, shendetsore nga TPL, dhe demet e sigurimit privat te shendetit. Kontrollet e kryera ne Departamentin e Demeve, VIG Services, jane fokusuar ne korrektesine e ekspertimit dhe saktësinë e vleresimit te demeve; ne funksionimin e kontrollit te proceseve brenda departamentit; ne kohezgjatjen e trajtimit te demeve dhe ne kujdesin per klientin.

Gjate auditimeve jane kontrolluar si databaza elektronike, rregjistrimet ne programin e demeve dhe dokumentat e skanuar elektronikisht, ashtu edhe dokumentacioni fizik i arkivuar i dosjeve te demeve te paguara.

Kontrollet ne trajtimin e demeve materiale nga produktet e detyrueshme kane konsistuar ne afatet e rregjistrimit dhe trajtimit ne perputhje me rregulloret e AMF, problematikave lidhur me funksionimin dhe permiresimin e programit informatik te trajtimi te demeve; ne referencat dhe manualet e cmimeve te perdorur per vleresimin e sakte dhe te drejte te demeve dhe kryerjes ne kohe te pageses se demshperblimit.

Permbushja e funksioneve te Departamentit te Administrimit është audituar gjatë vitit 2019 duke u fokusuar ne: grumbullimin dhe dorezimin ne Byro te policave te detyrueshme TPL, KJ dhe KUF (polica te furnizuara gjate vitit 2019 dhe te pashitura deri ne fund te vitit); rakordimet mujore te agjenteve te shitjes me deget dhe me drejtorine e pergjithshme; ne analizimin, ndjekjen dhe arketimin e primeve e paarketuara; ne kontrollin e inventarimit fizik te policave gjendje te furnizuara tek agjentet e shitjes; ne zbatimin e procedurave per leshimin e policave dublikate dhe anulimin e policat; ne funksionimin e programit Edusoft per administrimin e policave (rregjistrimi dhe raportimi ne nivel police, i primeve, arketimeve, debitoreve, komisioneve dhe inventarit); si dhe ne llogaritjen e komisioneve dhe bonuseve ne perputhje me urdhrat e brendshme te Bordit te Drejtoreve te Shoqerise.

Administrimi kontabël i shoqërisë është audituar për saktësinë e regjistrimeve në programin e kontabilitetit SAP tek VIG Services. Janë kontrolluar si edhe raportimet brenda afateve në institucionet jashtë shoqërisë (AMF, DPT, Drejtoria e Pastrimit të Parave etj.), si dhe raportimet e brendshme për Departamentet e tjera, Bordin Drejtues dhe Këshillin Mbikqyrës.

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2019 është audituar lidhur me shfrytëzimin e sistemeve dhe programeve informatike në përputhje me rregulloren e brendshme, implementimin e programit të ri të shitjes, administrimit dhe dëmeve (MBA), aplikimin e sakte të hierarkisë së drejtave të përdoruesve, rinovimin e pajisjeve hardëare dhe përditesimin e licencave në përdorim, dënieën e suportit IT për të gjithë përdoruesit e shërbimeve (punonjësit) si dhe mirëmbajtjen e sistemeve të sigurisë të instaluar në ambientet e shoqërisë.

Nga kontrollët në Departamentin e Ri-sigurimeve ka rezultuar se veprimtaria e risigurimit ka funksionuar e bazuar në Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", në Rregulloren e Grupit VIG për Risigurimet dhe në marrëveshjet e lidhura ndërmjet shoqërisë dhe risiguruesve përkatës. Partneri kryesor për aktivitetin e risigurimeve është VIG-RE i cili është pjesë e Vienna Insurance Group. Partnerët e tjerë janë përzgjedhur dhe miratuar bazuar në rankimet ndërkombëtare të institucioneve ndërkombëtare për shoqëritë e risigurimeve. Lista e risiguruesve është përditesuar periodikisht në përputhje me rregulloren e brendshme të Grupit VIG.

Kontrollet e auditit të brendshëm kanë konsistuar në përpushmërinë ligjore dhe të zbatimit të rregulloreve në fuqi, njoftimin në kohë dhe miratimin nga ana e Departamentit të Risigurimeve të Grupit VIG lidhur me risqet e mundshme dhe përcaktimin e ofertave. Gjithashtu janë audituar raportimet periodike në Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe në Grupin VIG lidhur me objektet dhe kontratat e risigurimeve.

Veprimtaria e Departamentit Ligjor është fokusuar në përfaqësimin dhe mbrojtjen e shoqërisë në proceset gjyqësore me objekt trajtimit të dëmeve, pasurore dhe jo-pasurore, si dhe ato të fondit të kompensimit. Gjithashtu pjesë e aktiviteteve juridike të shoqërisë janë ndjekja dhe mbështetja për grumbullimin primar të paarkëtuar nga klientët dhe subjektet debitorë. Kontrollet e kryera nga Auditimi i Brendshëm në aktivitetet juridike të shoqërisë gjatë vitit 2019 janë fokusuar në përcaktimin dhe vlerësimin e risqeve që mund të vijnë në nga zgjidhja me proces gjyqësor e marrëveshjeve.

### **Opinion i shkurtuar i Auditit të Brendshëm për vitin 2019**

Auditimet dhe kontrollet e realizuar gjatë vitit 2019 kanë mbuluar të gjitha aktivitetet e shoqërisë në përputhje me planin vjetor. Angazhimet audituese janë finalizuar me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, të cilat janë pasqyruar në raportet e auditimit të dërguara në Bordin Drejtues të Shoqërisë Sigma Inter-Albanian VIG sh.a dhe në Këshillin Mbikqyrës të saj.

Drejtori i Auditit të Brendshëm ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me Komitetin e Auditimit dhe Bordin Drejtues, duke marrë mbështetje të plotë për realizimin e rekomandimeve. Në mënyrë të vazhdueshme Departamenti i Auditit të Brendshëm ka monitoruar dhe dokumentuar realizimin e rekomandimeve të miratuara dhe statusin përfundimtar të tyre.

Bazuar në rezultatet e auditimeve të kryera gjatë vitit, Auditimi i Brendshëm mund të japë siguri të arsyeshme që aktivitetet e shoqërisë Sigma Inter-Albanian VIG gjatë vitit 2019 janë kryer në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për tregun e sigurimeve në Shqipëri. Gjithashtu, në angazhimet audituese nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale të konsiderueshme, të cilat të kenë një impakt domethënës në aktivitetin e Shoqërisë.

## Objektivat e Kompanisë- 2020

Duke marrë shkas nga katastrofat natyrore të ndodhura gjatë vitit 2019, dhe faktit që Shqipëria gjendet në një zonë sizmike, një ndër objektivat kryesore ka qënë rritja e sigurimeve vullnetare të pronës dhe shëndetit si proces që zhvillon tregun e sigurimeve dhe sigurinë financiare shoqërore. Në fund të vitit 2019 dolën lajmet e para nga Kina në lidhje me COVID-19 (koronavirus). Situata në fund të vitit karakterizohej nga një numër i kufizuar i rasteve të një virusi të panjohur sipas raporteve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Në muajt e parë të vitit 2020 virusi dhe ndikimi i tij negativ u përhapën globalisht. Që nga fillimi i muajit mars, Shqipëria vendosi bllokimin dhe shtetrrëhimin për të kufizuar përhapjen e pakontrolluar të sëmundjes.

Transporti ajror dhe tokësor ishin të bllokuar ashtu si sistemi arsimor dhe aktiviteti tregtar përveç disa industrive që konsiderohen si thelbësore. Lëvizja e këmbësorëve dhe automjeteve është e kufizuar në ditë dhe orare të përcaktuara vetëm me leje të posaçme. Kompania e konsideron përhapjen e sëmundjes si një ngjarje jo të favorshme. Ndërkohë që situata në fund të vitit 2019 ishte në zhvillim të vazhdueshëm, efektet e ardhshme nuk mund të parashikohen. Sigma Interalbani i ka marrë të gjitha masat e nevojshme që të vazhdojë t'i shërbejë klientit në çdo kohë, si në ofrimin e shërbimeve ashtu edhe në trajtimin e dëmeve. Shitjet online, edhe pse jo kanali tradicional i shitjes, janë një mundësi e mirë për t'u pajisur me siguracionin e nevojshëm.

Duke pasur parasysh ndërvarësinë e situatës dhe aktivitetit tregtar me kufizimin e transportit dhe lëvizjes së njerëzve që ndikojnë në policat TPL, kasko, kufitare dhe karton jeshil, Shëndet në Udhëtim, kompania mund të ndryshojë objektivat financiare dhe duke rregulluar aktivitetet sipas rrethanave. Gjithashtu, duke iu bashkuar iniciativave të grupit VIG, kemi filluar të implementojmë raportimin ad – hoc ORSA.



## Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A.

---

### Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A. ("njësia raportuese") për vitin financiar të mbyllur më 31 dhjetor 2019, janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare ("AMF").

#### Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të njësisë raportuese të përgatitura për raportim specifik përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar të përgatitur për raportim specifik më 31 dhjetor 2019;
- pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse të përgatitur për raportim specifik për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e lëvizjeve të kapitalit të përgatitur për raportim specifik për vitin e mbyllur në atë datë;
- pasqyrën e flukseve të parasë të përgatitur për raportim specifik për vitin e mbyllur në atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të përgatitura për raportim specifik, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

---

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin *Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare për raportim specifik* të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

#### Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga njësia raportuese në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

---

### Çështje për tu theksuar – Baza e kontabilitetit dhe kufizimi i shpërndarjes dhe përdorimit

Ne tërheqim vëmendjen në Shënimin shpjegues numër 2 në pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik, i cili përshkruan bazat e kontabilitetit. Pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik janë përgatitur në përputhje me kërkesat për raportimin financiar të AMF-së. Për rrjedhojë, pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. Opinionin ynë nuk përmban rezervë në lidhje me këtë çështje.

*Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Ndërkohë, janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.*

---

## Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë Aftësinë Paguese dhe Aktivet në Mbulim të Rezervave Teknike (por nuk përfshijnë pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik dhe raportin tonë të auditimit).

Opinionin ynë për pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik nuk përfshin informacionet e tjera dhe ne nuk japim asnjë lloj formë sigurie në lidhje me të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare të përgatitura me qëllim specifik, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar të raportojmë këtë çështje. Ne nuk kemi diçka për të raportuar në lidhje me këtë çështje.

---

## Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik

Drejtimi i njësisë raportuese, është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare për raportim specifik në përputhje me kërkesat e AMF, dhe për kontrollet e brendshme të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare të përgatitura për raportim specifik pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të përgatitura për raportim specifik, drejtimi i njësisë raportuese është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e njësisë raportuese për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë njësinë raportuese apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen e njësisë raportuese janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të njësisë raportuese.

---

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të përgatitura për raportim specifik

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare të përgatitura për raportim specifik.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne::

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare të përgatitura për raportim specifik, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë raportuese.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e njësisë raportuese për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të përgatitura për raportim specifik ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së njësisë raportuese.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e njësisë raportuese, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

*PricewaterhouseCoopers Kosovo sh.p.k.*

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.

14 prill 2020

Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjor

Jonid Lamllari



**Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A.**  
**Pasqyra e pozicionit financiar për raportim specifik**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>AKTIVET</b>			
Aktive të trupëzuara dhe të patrupëzuara	11	304,733	314,975
Aktive të mbajtuara për investime	12	72,850	72,850
Aktive me te drejte perdorimi	13	54,441	-
Aksione në shoqëri të lidhura dhe degë	14	215,797	215,797
Aktive të risigurimit	15	1,875,479	1,213,866
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	16	1,671,207	1,415,131
Tatim fitimi i parapaguar		-	11,105
Depozita me afat me bankat	17	859,336	876,169
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	18	271,451	263,925
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	19	127,226	157,777
Aktive të tjera	20	121,468	115,134
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to	21	199,688	208,554
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>5,773,676</b>	<b>4,865,283</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali aksionar	22	498,213	498,213
Rezerva e rrezikut të sigurimit	23	171,792	171,792
Rezerva e rivlerësimit	23	64,683	68,660
Rezerva e bashkimit	23	333,207	387,207
Fitime / (Humbje) të mbartura		126,583	31,269
<b>TOTALI I KAPITALIT</b>		<b>1,194,478</b>	<b>1,157,141</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Detyrime për kontratat e sigurimit	24	2,345,694	1,488,125
Rezerva për primet e pafituara	28	1,091,812	1,052,158
Detyrime tatimore të shtyra	37	7,205	7,907
Detyrime tatimore dhe të tjera	25	38,039	17,796
Depozita e risiguresit	26	889,486	893,697
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	27	151,642	248,459
Detyrim per qira afatgjate	13	55,320	-
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>4,579,198</b>	<b>3,708,142</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>5,773,676</b>	<b>4,865,283</b>

**Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A.**

**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për raportim specifik**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Prime të shkruara bruto	28	2,244,704	2,219,929
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara bruto	29	(39,653)	(46,606)
<b>Te ardhura nga primet e sigurimit</b>		<b>2,205,051</b>	<b>2,173,323</b>
Prime të ceduara të risiguruesit	30	(1,016,673)	(1,009,418)
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit për primet e pafituara		32,127	(7,505)
Prime neto te ceduara te risiguruesi		<b>(984,546)</b>	<b>(1,016,923)</b>
<b>Prime të fituara neto</b>		<b>1,220,505</b>	<b>1,156,400</b>
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	31	540,536	511,413
Të ardhura nga investimet	32	99,622	89,052
Të ardhura të tjera	33	3,848	5,565
<b>Të ardhura neto</b>		<b>1,864,511</b>	<b>1,762,430</b>
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto		(857,569)	105,765
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguruesit		629,486	(168,943)
Dëme të paguara bruto	24	(898,605)	(2,092,080)
Dëme të paguara nga risiguruesi	24	406,920	1,473,086
<b>Dëmet neto të sigurimit</b>		<b>(719,768)</b>	<b>(682,172)</b>
Shpenzimet të marrjes në sigurim	34	(621,752)	(629,258)
Shpenzime administrative	35	(351,612)	(335,631)
Shpenzime të tjera sigurimi	36	(43,835)	(35,114)
<b>Shpenzime</b>		<b>(1,736,787)</b>	<b>(1,682,175)</b>
Shpenzime financiare		(8,486)	(10,630)
Të ardhura nga kurset e këmbimit, neto	33	1,212	30,063
Transfertë në mjete monetare nga dega		29,066	24,161
<b>Fitim/(humbje) para tatimit</b>		<b>149,516</b>	<b>123,849</b>
Tatimi mbi fitimin	34	(27,179)	(22,738)
<b>Fitim/(humbje) e vitit</b>		<b>122,337</b>	<b>101,111</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:</b>			
Të ardhura nga rivlerësimi i aktive të qëndrueshme të trupëzuara		4,679	4,679
Tatimi i shtyrë i njohur në të ardhurat gjithëpërfshirëse		(702)	(702)
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat</i>		3,977	3,977
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>126,314</b>	<b>105,088</b>

**Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A.**

**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për raportim specifik**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Kapitali aksionar	Rezerva e sigurimit	Rezerva e bashkimit	Rezerva e rivlerësim it	Fitim/ (Humbje) e mbartur	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>	<b>498,213</b>	<b>171,792</b>	<b>437,207</b>	<b>74,215</b>	<b>(73,820)</b>	<b>1,107,607</b>
Fitimi i vitit			-	-	101,111	101,111
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksa	-	-	-	(3,977)	3,977	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(3,977)</b>	<b>105,089</b>	<b>101,111</b>
Shpërndarje dividendi			(50,000)			(50,000)
Rregullim për zhvlerësimin				(1,577)		(1,577)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>498,213</b>	<b>171,792</b>	<b>387,207</b>	<b>68,660</b>	<b>31,269</b>	<b>1,157,141</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2019</b>	<b>498,213</b>	<b>171,792</b>	<b>387,207</b>	<b>68,660</b>	<b>31,268</b>	<b>1,157,141</b>
Fitimi i vitit			-	-	122,337	122,337
Rregullim për zhvlerësimin				-		-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksa	-	-	-	(3,977)	3,977	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(3,977)</b>	<b>126,314</b>	<b>122,337</b>
Shpërndarje dividendi			(54,000)	-	(31,000)	(85,000)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>498,213</b>	<b>171,792</b>	<b>333,207</b>	<b>64,684</b>	<b>125,582</b>	<b>1,194,478</b>

**Sigma InterAlbanian Vienna Insurance group SH.A.**

**Pasqyra e flukseve monetare për raportim specifik**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>149,516</b>	<b>123,849</b>
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet operative</b>			
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	10	54,883	29,038
Humbja nga zhvlerësimi i aktive të mbajtuara për investime	11	(647)	14,230
Zhvlerësimi për sigurimet e arkëtueshme	17	11,600	15,000
Të ardhura nga investimet	32	(99,622)	(89,052)
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>		<b>115,730</b>	<b>93,065</b>
Ndryshime në të arkëtueshmet nga sigurimi e të tjera	19	18,952	62,070
Ndryshime në aktivet e tjera	20	(6,335)	21,191
Ndryshime në aktive të risigurimit	15	(661,613)	176,448
Ndryshime në kostot e shtyra të marrjes së sigurimit	18	(7,525)	8,144
Ndryshime në detyrime për kontratat e sigurimit	24	857,569	(105,765)
Ndryshime në rezervën për primet e pafituara	23	39,653	46,606
Ndryshime në detyrime të tjera	26	20,243	(15,793)
Ndryshime në të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	26	(101,028)	23,136
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative përpara interesave dhe taksës</b>		<b>275,646</b>	<b>309,102</b>
Interes i marre		<b>1,727</b>	
Tatim fitimi i paguar		(15,250)	(22,706)
<b>Flukset monetare neto nga aktivitetet operacionale</b>		<b>262,123</b>	<b>286,396</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese</b>			
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	10	(21,755)	(40,418)
Blerje e letrave me vlerë me kosto të amortizuar		(289,108)	(157,209)
Arkëtime nga letrat me vlerë të maturuara		40,000	35,000
Rënie në depozitat me afat	15	23,739	(86,267)
Interes i arkëtuar		85,749	84,063
Rritje në aksione në shoqëri të lidhura		-	(3,250)
<b>Flukset monetare neto të përdorura nga aktivitetet investuese</b>		<b>(161,375)</b>	<b>(168,081)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet finacuese</b>			
Qira të paguara		(24,614)	
Dividend i paguar		(85,000)	(50,000)
<b>Flukset monetare të përdorura në aktivitetet finacuese</b>		<b>(109,614)</b>	<b>(50,000)</b>
Ulje/(rritje) neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		(8,866)	68,315
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fillim të vitit		<b>208,554</b>	<b>140,239</b>
Efekt i kursit të këmbimit në mjetet monetare		-	-
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to në fund të vitit</b>	<b>19</b>	<b>199,688</b>	<b>208,554</b>

